

Organizimi i klasës në punë me grupe në edukimin në distancë

David LEBOURG , Karolina LEBOURG, Clémentine SOAS

L.E.A.R.N. Institute Laigneville, France

info@learninstitute.net

Abstrakt: Shfaqja e papritur e COVID-19 vuri në vështirësi madhe sistemin shkollor në Francë dhe jashtë saj, duke ndërprerë përkohësisht edukimin në klasë. Pothuajse brenda natës, shkollave dhe mësuesve iu kërkua të përshtatnin dhe adoptonin strategji të reja për të mos humbur kontaktin me studentët. Qëllimi i këtij studimi është të japë një pasqyrë mbi sfidat me të cilat u përballen të gjitha palët e interesuara në Francë (nxënës, mësues, familje) gjatë kësaj periudhe si edhe të tregojë disa mënyra se si mësuesit trajtuan kompleksitetin e menaxhimit të klasës në një mjedis virtual. Të dhënat e studimit janë si rezultat i studimit të një grupi prej 64 mësuesish nga katër shkolla të ndryshme fillore në të njëjtën zonë gjeografike në Francë. Të dhënat u mbledhën kryesisht përmes pyetësorëve të dërguar me email si dhe intervistave ballë për ballë. Rezultatet tregojnë se u ngritën tre shqetësime kryesore: 1) ruajtja e kontaktit dhe rikrijimi i kushteve të favorshme mësimore në një fushë të kufizuar veprimi 2) përshtatja e pedagogjisë në një kontekst sfidues 3) sigurimi i zërit dhe hapësirës për studentët. Punimi diskuton rëndësinë e zbatimit të strategjive të komunikimit të krijuara për të përmbushur nevojat emocionale dhe arsimore të nxënësve përmes aktiviteteve të punës në grup, gjatë të cilave fokusi kryesor i mësuesve ishte më shumë në aftësitë sociale sesa në performancën akademike.

Fjalët kyçe: menaxhim i klasës, klasë virtuale, punë në grup, mësimdhënie në distancë, pandemia COVID-19, ndërveprim në internet

1. Hyrje

Që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, edukimi në distancë, i cili në kontekstin e këtij studimi ka kuptimin “model i mësimdhënies dhe të nxënësve në të cilin mësuesit dhe studentët janë të ndarë gjeografikisht dhe komunikojnë midis tyre duke përdorur teknologjinë” (Gunawardena & McIsaac, 2004), është bërë një mjet i domosdoshëm në të gjithë spektrin pedagogjik të mësuesve. Shpejtësia me të cilën ka ndodhur ky ndryshim, ka bërë që institucionet dhe mësuesit të investojnë kohë, përpjekje dhe burime financiare shtesë për të siguruar vazhdimësinë e kurrikulës. Për shumë profesionistë të arsimit, kjo mënyrë e mësimdhënies ka krijuar ankth se si të drejtojnë klasa virtuale në mënyrë që studentët të vazhdojnë të fitojnë aftësitë dhe njohuritë e përcaktuara nga kurrikula (Son, 2018).

Nëse brenda një kohe mjaft të kufizuar, këto shqetësime u vendosën në një nivel të dytë për t'u fokusuar më shumë në aftësitë sociale dhe mirëqenien e studentëve, ato natyrisht u rishfaqën në një fazë të mëvonshme si një sfidë madhore (Mardiani & Azhar, 2021). Rrjedhimisht, strategjitë e reja në menaxhimin e klasës do të zhvilloheshin me sukses për të përmbushur të dyja kërkesat. Nga hapësira fizike e klasës ku mësuesit dhe studentët mund të komunikonin, me shumë pak vështirësi, përmes fjalëve dhe gjuhës së trupit, do të kalohej në një hapësirë virtuale e cila mbështetet në mungesën e problemeve teknike dhe në përdorimin e kualifikuar të një sërë mjetesh si audio, video, biseda me mesazhe, tabela e bardhë e përbashkët, sondazhet ose ndarja e skedarëve, dhe për të arritur këtë duheshin futur rregulla të reja për të siguruar komunikim (Mardiani & Azhar, 2021), (Nurfauziah & Suryaman & Mobit, 2022), (Khalid, 2022). Përkufizimet tradicionale të menaxhimit të klasës zakonisht rrotullohen rreth nocioneve të ndërveprimit dhe sjelljes ndërmjet studentëve dhe mësuesve. Për shembull, shkencëtarët e përkufizojnë atë si "proces me të cilin mësuesit inkurajojnë dhe mbajnë sjelljen e duhur të studentëve në mjediset e klasës". (Emmer & Sabornie, 2015; Everston & Weinstein, 2006). Qëllimi është "të përmirësohet sjellja pro-sociale tek studentët dhe të rritet angazhimi akademik në të gjitha fushat lëndore dhe nivelet e klasave". Zakonisht, e konsideruar si nevoja më e madhe për zhvillim profesional, menaxhimi i klasës i transferuar në mjedise të ndryshme mund të bëhet mjaft sfidues. Mungesa e zotërimit të teknologjisë, problemet teknike, mungesa e materialit të përshtatshëm

etj, janë të gjitha pengesa që duhen kapërcyer në edukimin në distancë. Në këtë studim, prioritet i është kushtuar inkurajimit si edhe është bërë një përpjekje e madhe për ruajtjen e një lidhjeje sociale me studentët. Për ta bërë këtë, mësuesit hartuan planet mësimore në një mënyrë që favorizon ndërveprimin bashkëmoshatar dhe promovon aftësitë sociale kryesisht përmes aktiviteteve të punës në grup dhe bashkëpunimit. Edhe pse puna në grup është konsideruar si një element kryesor i edukimit, të paktën që nga fillimi i shekullit XX (Illris, 1978), dinamika e grupit në një mjedis virtual kërkon cilësi të tjera si për studentët ashtu edhe për mësuesit dhe mund të shërbejë për qëllime të tjera që janë ndryshe nga rastet kur zbatohet në hapësirën fizike të një klase tradicionale. Sipas Ellice A. Forman dhe Courtney B. Cazden (1985), mund të përcaktohen tre stile kryesore të punës në grup të cilat variojnë nga ndërveprimet paralele gjatë të cilave studentët komentojnë për detyrën, por nuk ofrojnë shkëmbim idesh, tek ndërveprimet shoqëruese gjatë të cilave studentët ndajnë informacione, por ku asnjë rol nuk është koordinuar zyrtarisht, deri te ndërveprimet bashkëpunuese gjatë të cilave studentët shkëmbejnë ide dhe përfshihen aktivisht së bashku në mënyrë bashkë-krijuese. Mësuesit mund të planifikojnë dhe parashikojnë aktivitete dhe udhëzime sipas nivelit të përfshirjes së nevojshme për mësimet e tyre. Sfidat qëndron në vështirësinë për të organizuar aktivitete dhe detyra që i lejojnë studentët të gjejnë vendin dhe zërin e tyre duke dhënë udhëzime të qarta për të reduktuar rreziqet e moskuptimit, braktisjes ose shpërqendrimit. Siç tregojnë studimet e mëparshme, vendosja e pritshmërive të qarta është kryesore për të shmangur sjelljen e keqe dhe mosangazhimin (Lowes, 2014), (Robert, 2016), (Khalid, 2022) për të mos përmendur që udhëzimet mund të drejtohen gjithashtu mbi atë që mësuesit presin nga bashkëpunimi. Prandaj pyetja që lind është si duhet organizuar menaxhimi i klasës në mënyrë që të shmangen sfidat e përmendura në këto studime të mëparshme. E konsideruam të rëndësishme që të hulumtojmë se cilat strategji do të funksiononin dhe ku duhej të përqendroheshin mësuesit për t'u lënë nxënësve hapësirë dhe vend në një mjedis virtual. Për të mbledhur të dhënat, pyetësorët u dërguan në dy periudha të ndryshme për t'i lejuar mësuesit që të reflektonin mbi rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e strategjive që ata përdorën gjatë mësimit në distancë.

2. Metodologjia e kërkimit

Në këtë studim u përdor metoda cilësore e studimit të rastit. Të dhënat u morën nëpërmjet kryerjes së intervistave gjysmë të strukturuar dhe nga pyetjet e dërguara tek pjesëmarrësit me email në dy periudha të ndryshme. Pjesëmarrësit, që ishin të gjithë mësues të shkollave fillore nga e njëjta zonë gjeografike në Hauts-de-France, morën dy seri pyetjesh të cilat u dërguan me një distancë dy mujore nga njëra-tjetra për të lejuar mësuesit që të reflektonin mbi rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e strategjive të tyre dhe që ne të bënim intervista. Të dhënat e mbledhura u analizuan për ngjashmëritë dhe dallimet në përvojën e mësuesve.

3. Rezultatet e studimit

Artikulli diskuton dhe analizon përgjigjet nga pjesëmarrësit në studim bazuar në pyetësorët e dërguar me email,

P.1 Sipas jush, cila ishte sfida më e madhe me të cilën u përballët gjatë edukimit në distancë?

Përmes rezultateve të treguara në shtojcën nr. 1 të pyetësorit, 46 pjesëmarrës nga 64 pohuan se pjesa më sfiduese e edukimit në distancë gjatë pandemisë ishte mbajtja e kontaktit me studentët e tyre. 51 pjesëmarrës nga 64 deklaruan se për shkak të prejardhjes së përgjithshme sociale dhe ekonomike të familjeve që banojnë në zonë, studentët nuk kishin domosdoshmërisht materialet dhe as kushtet e nevojshme për të kaluar në klasa virtuale. Theksi kryesor fillimisht ishte që familjet të mësoheshin me këtë ndryshim "rrënjësor" duke u shpjeguar mënyrat dhe kërkesat e reja të mësimit në distancë.

P.2 Cilat janë problemet e të cilat u përballën studentët gjatë kësaj periudhe dhe çfarë ndikimi pati në mësimet tuaja?

Pyetja nr. 2 thekson rëndësinë e përcaktimit të një orari të përshtatur me ritmin 24 orësh të nxënësve gjatë kësaj periudhe qëndrimi në shtëpi. 39 pjesëmarrës nga 64 pohuan se shumica e nxënësve ishin të

privuar nga gjumi dhe nuk ishin në gjendje të ndiqnin të njëjtin orar me atë që kishin në hapësirën fizike të shkollës. Gjithashtu është dashur të shkurtrohet kohëzgjatja e mësimeve për të kapërcyer mungesën e përqendrimit dhe nevojën për aktivitet fizik.

P.3 Pasi kaluat në klasa virtuale, cili ishte prioriteti juaj dhe pse?

Në përgjigje të shtojcës nr. 3 të pyetësorit, 32 pjesëmarrës theksuan sfidat me të cilat u përballën për t'i dhënë secilit nxënës hapësirën për t'u përfshirë në mënyrë aktive gjatë mësimeve. Kur u intervistuan, pjesëmarrësit deklaruan se studentët shpesh nuk ishin në gjendje të respektonin rregullat dhe kërkonin vazhdimisht kontakte sociale në vend që t'i kushtonin vëmendje mësimit.

P.4 A keni vërejtur ndonjë ndryshim në sjelljen e studentëve tuaj në krahasim me edukimin në klasë?

Shtojca nr 4 e pyetësorit tregon se shumica e pjesëmarrësve shpenzuan një kohë jo të papërfillshme për të qetësuar studentët për situatën. Thuhej se studentët ishin të stresuar nga pandemia dhe shpesh kërkonin mbështetje emocionale. Kur u intervistuan, pjesëmarrësit shtuan se edhe familjet kërkonin më shumë kontakt me mësuesit dhe administratën e shkollës. Prindërit ishin të shqetësuar dhe donin të kishin informacion.

P.5 Çfarë vështirësish keni hasur gjatë kryerjes së aktiviteteve që keni planifikuar për klasën tuaj virtuale?

Në përgjigje të pyetjes nr. 5, shumica e pjesëmarrësve theksuan vështirësinë që studentët të përqendrohen në detyrat që do të kryhen. Ose për shkak të shpërqendrimeve të shkaktuara nga mjedisi në shtëpi ose nga problemet teknologjike, studentët shpeshherë nuk reagonin ndaj udhëzimeve të mësuesve. Kështu, pjesëmarrësit deklaruan se duhet të kalonin pak kohë përpara mësimeve për t'u siguruar që udhëzimet dhe pritshmëritë ishin mjaft të qarta dhe të arsyeshme që të kuptoheshin nga secili student.

P.6 A ju është dashur të përshtatni menaxhimin e klasës gjatë mësimit tuaj në distancë?

Pjesëmarrësit pohuan me shumicë dërrmuese se mënyra se si ata zbatojnë menaxhimin e klasës në distancë ishte dukshëm e ndryshme nga ajo që ndodhë zakonisht brenda hapësirës fizike të klasës. Ata deklaruan se, si domosdoshmëri, duhet të merren parasysh edhe pika të tjera me interes si lënia e më shumë kohe dhe hapësire për secilin student ose zgjidhja e çështjeve teknike. Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu faktin se çdo udhëzim dhe rregull duhej të përsëritej disa herë përpara se të fillonin aktivitetet. Prandaj, menaxhimi i kohës ishte një çështje e rëndësishme për përparimin e suksesshëm të mësimeve.

P.7 Si u siguroat që studentët të përfitonin nga mësimi në distancë?

Duke iu përgjigjur pyetjes nr. 7, 57 pjesëmarrësit pohuan se studentët përfituan nga një sërë aktiviteteve më të shkurtra, të cilat kryesisht mbështeteshin në ruajtjen e aftësive sociale tek studentët. Aktivitetet ishin planifikuar dhe projektuar në mënyrë që të kërkonin nga studentët një analizë të përbashkët të detyrave që do të kryheshin. Pas orëve të mësimit dërgoheshin udhëzime shtesë për të konsoliduar njohuritë, por gjatë orëve të mësimit studentët nxiteshin që të shkëmbejnë pikëpamje dhe mendime rreth çështjeve në fjalë. Në këtë mënyrë, studentët formulonin konceptet dhe njohuritë duke mbajtur kontakte shoqërore me bashkëmoshatarët e tyre.

P.8 Si i keni përdorur strategjitë e punës në grup gjatë mësimeve tuaja?

Në përgjigje të pyetjes nr. 8, shumica e pjesëmarrësve deklaruan se dinamika e punës në grup u përdor gjerësisht pas mësimeve të para, gjatë të cilave mësuesit kishin qenë më të orientuar drejt punës individuale. Sfidat me të cilat u përballën pjesëmarrësit ishin kryesisht teknike. Puna në grup kërkonte ngritjen e dhomave të ndryshme virtuale në të cilat studentët ndaheshin sipas detyrave që do të kryenin. Kur u intervistuan, mësuesit shtuan se zbatimi i punës në grup në një kontekst virtual kërkon më shumë pritshmëri dhe vëmendje sesa në edukimin ballë për ballë. Megjithatë, pjesëmarrësit ranë dakord për faktin se dinamika e punës në grup i lejoi studentët të jenë më aktivë në aktivitetet e planifikuara. Studentët gjithashtu dukej se ishin më të motivuar dhe ndiheshin më të sigurt për të shkëmbyer ide ndërsa ishin në grupe më të vogla.

4. Diskutimi

Rezultatet e marra nga pyetësorët tregojnë se si në studimet e mëparshme të përmendura në këtë artikull, aftësitë teknologjike të treguara nga mësuesit janë vendimtare për mësimin në distancë.

5. Përfundimi

Rezultatet e hulumtimit treguan se edukimi në distancë kërkon që mësuesit të përshtatin mësimin e tyre me specifikat e klasës virtuale. Menaxhimi i klasës kërkonte vendosjen e një theksi më të madh në mirëqenien e nxënësve dhe komunikimin nga bashkëmoshatarët. Për ta bërë këtë, mësuesit hartuan aktivitete që kërkonin punë në grupe të vogla. Studentët performuan më mirë kur këto aktivitete ishin të shkurtra dhe kur mësuesit linin kohë për diskutim dhe shkëmbim idesh. Mësuesit gjithashtu duhej të siguroheshin që çështjet teknike të mos ndërhyjnë në mbarëvajtjen e mësimin. Për ta bërë këtë, mësuesit bashkëpunuan me familjet për të krijuar kushtet e nevojshme që studentët të kryenin punën e tyre.

Referencat

- Afrillia Nurfauziah, Maman Suryaman, Mobit (2022). Menaxhimi në sinkron i klasës virtuale: Sfidat dhe strategjitë e përdorura nga mësuesit e gjuhës angleze. *Professional Journal of English Education Vëllimi 5 Nr 1, Janar 2022*.
- Ekblaw Robert (2016). Përdorimi efektiv i projekteve në grup në mësimin në internet. *Contemporary Issues in Education Research – Tremujori i Tretë 2016 Vëllimi 9, Numri 3*.
- Falloon Garry (2012). Brenda klasës virtuale: Perspektiva e studentëve mbi mundësitë dhe kufizimet. *Journal of Open, Flexible, and Distance Learning Vëllimi 16, Numri 1, 2012*.
- Hausstatter Rune Sarromas, Nordkelle Yngve Troye (2007). Perspektiva mbi punën në grup në mësimin në distancë. *Turkish Online Journal of Distance Education – TOJDE Vëllimi: 8 Numri: 1 Artikulli: 8*.
- Kiseleva Margarita, Pogosian Victoria (2008). Menaxhimi i klasës virtuale. *SHS Web of Conferences 97 (2021): 01023*. <http://dx.doi.org/10.1051/shsconf/20219701023>.
- Lowe Susan (2014). Sa "grup" ka në punën në grup në internet? *Journal of Asynchronous Learning Networks, v 18 n1 2014*.
- Milliken, Kaytlynn (2019) "Menaxhimi i klasës në distancë; zhvillim profesional për mësuesit fillestar" *Digital Commons @ ACU, Electronic Theses and Dissertations Gazeta 177*
- Ridha Mardiani, Ridha Nurul Azhar (2021). Kapërcimi i sfidave në klasën virtuale për të ruajtur menaxhimin efektiv të klasës dhe kulturën e klasës: një rast studimi në një shkollë profesionale. *Journal Sampurasun : Interdisciplinary Studies for Cultural Heritage Vëll. 07, Numri 02, Dhjetor 2021*.
- Siti Aishah Taib, Siti Mariam Mohammad Iliyas, Maisarah Noorezam, Nadzrah Sa'adan, Noor Shahariah Saleh, Norhisyam Jenal (2021). Eksplorimi i fazave të njohurive përmes punës në grup dhe angazhimit në internet. *International Journal of Academic Research in Business and Social Sciences Vëll. 11, nr. 11, 2021*.
- Stewart Daniel P (2008). Menaxhimi i klasës në mjedisin online. *MERLOT Journal of Online Learning and Teaching Vëll. 4, nr 3, shtator 2008*.
- Telal Mirghani Hassan Khalid (2022). Menaxhimi i klasës në mësimin virtual: Një studim i perceptimeve me mësuesit e shkollave në Katar. *World Journal of English Language Vëll. 12, nr 2; 2022. Numri special*.